

Eshalas AB

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Eshalas AB është një membranë bituminoze me vetëngjitje, e cila ofron zgjidhje ideale për hidroizolim të materialeve të ndërtimit të rrugëve. Kombinimi i fleksibilitetit të përhershëm dhe ngjitjes së shkëlqyer, garanton një izolim afatgjatë edhe në rast ngarkesash të mëdha, të cila shfaqen nga kontraksionet termike.

APLIKIMI

Eshalas AB është krijuar për izolimin (horizontal dhe vertikal) në bashkime të ndryshme (të asfaltit).

Është prodhuar:

- për masa asfalti të ftohta
- ndërmjet asfaltit dhe betonit, ose ndërmjet dy pjesëve të betonit.
- në zonat e depërtimit në rrugë (puseta)
- ndërmjet asfaltit dhe çelikut (në pista dhe shinat e tramvajit)

ÇERTIFIKIMI

Eshalas AB është prodhuar sipas sistemit të cilësisë ISO 9001.

APLIKIMI


Nëse jeni duke përdorur membranën Eshalas AB, së pari duhet të hiqni paketimin e jashtëm. Shiriti ngjitës duhet të hapet dhe të ngjyhet kundrejt pjesës së brendshme të fugave. Letrën e silikonit hiqeni pak momente përpara se të aplikohet masa e asfaltit, duke siguruar kështu pastërtinë e membranës dhe një izolim të mirë.

Zona e aplikimit

Membrana Eshalas AB mund të aplikohet pothuajse mbi të gjitha sipërfaqet. Natyrisht që pluhuri, rëra, lagështia, dhe mbetje të tjera të panevojshme duhet të largohen paraprakisht. Për një ngjitje optimale mbi metal dhe beton, nënshtresa duhet të mbulohet me astar „Siplast Primer”. Nëse nënshtresa është e lagësht, mund të ndikojë në fortësinë e ngjitjes së membranës, karakteristikat e tjera mbeten të pandryshuara. Në këtë rast rekomandohet një ngrohje e lehtë e nënshtresës.

Masa mbrojtëse

Asnjë masë mbrojtëse e veçantë nuk kërkohet. Zakonisht rekomandohet të vishen rroba pune dhe doreza.



BMI

VILLAS

BMI Bramac Sisteme për çati Sh.p.k
Rr. "Ismail Qemali", Pall. 12 katësh (i ri)
Kati III, Zyra 6
1001 Tirana, Albania

www.bmigroup.com

Mënyra e pastrimit

Fillimisht pastrojeni pajisjen me avull uji. Sasi më të mëdha të bitumit mund të pastrohen mekanikisht, pjesa tjetër me një tretës të holluar.

KONSUMI

Kur përdoret vertikalisht, konsumi korrespondon me trashësinë e shtresës së asfaltit.

PAKETIMI

Dorëzimi

Eshalas AB është në dispozicion në dimensione standarte si më poshtë:

- 5 mm trashësi x 40 mm gjerësi x 10 m gjatësi
- 6 mm trashësi x 20 mm gjerësi x 10 m gjatësi
- 6 mm trashësi x 35 mm gjerësi x 10 m gjatësi

Në çdo kuti ka 6 rulona, me porosi të veçantë janë të mundshme edhe dimensione të tjera.

Magazinimi dhe jetëgjatësia

Eshalas AB duhet të ruhet në një vend të thatë dhe të freskët, pa u ekspozuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ndaj lagështirës apo rrezeve të diellit. Jetëgjatësia e produktit është 2 vjet nga data e prodhimit.

SIGURIA DHE MBROJTJA E MJEDISIT

Eshalas AB nuk përmban tretës organikë dhe mund të riciklohet. Nuk ka rreziqe ose udhëzime sigurie të veçanta për Eshalas AB.

Eliminimi i mbetjeve

~~Të gjitha paketimet e zbrazura duhet të eliminohen në përputhje me rregulloret lokale. Mbetjet e produktit mund të ripërdoren si bitume, ose të depozitohen në përputhje me Kodin Evropian 17 03 02.~~


TË DHËNA TEKNIKE

Elasticiteti ndaj tërheqjes (23 °C, 40mm/min)	3000 %
--	--------

Rikuperimi i elasticitetit	90%
----------------------------	-----

Fleksibiliteti gjatë matjes së konstistencës	57 / 0,1mm NEN 3949
--	---------------------

Fleksibiliteti në temperaturë të ulët	-15 °C DIN 52123
---------------------------------------	------------------



BMI

VILLAS

BMI Bramac Sisteme për çati Sh.p.k
Rr. "Ismail Qemali", Pall. 12 katësh (i ri)
Kati III, Zyra 6
1001 Tirana, Albania

www.bmigroup.com